



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 10 dhjetor 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, , Afrim Hoti, Albert Kinolli, Bali Muharremaj, Valbona Dibra dhe Adem Grabovci.

Munguan: Imri Ahmeti,

I ftuar: Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm, z. Skënder Komoni, Zëvendës - Kryesues dhe Drejtor AKP dhe z. Shkelzen Lluka, Drejtor Menaxhues.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica zyrtar i fushës në Komision dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.12.2013;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjensionit Kosovar të Privatizimit dhe Fondit të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 04.12.2013;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 04 dhjetor 2013.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjensionit Kosovar të Privatizimit dhe Fondit të Privatizimit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari - Theksoi se Opinioni i Auditimit për Agjensionin Kosovar të Privatizimit (AKP) dhe Fondit të Privatizimit (FP) për vitin 2012 është i kualifikuar, që nënkupton se PVF nuk ishin të pasqyruara drejtë dhe sakët. Po ashtu ZAP ka ngritur çështjen e mos adresimit të plotë të rekomandimeve nga viti i kaluar. Nga 7 rekomandime për AKP të dhëna për vitin 2011, 3 prej tyre janë adresuar plotësisht, ndërsa 4 prej tyre në proces të adresimit. Po ashtu për FP janë dhënë 8 rekomandime për vitin 2011, prej tyre 2 janë adresuar plotësisht, ndërsa 6 prej tyre në proces të adresimit. Po ashtu ZAP ka konstatuar dobësi të theksuara në procedurat juridike për kandidimin dhe përzgjedhjen e Bordit të Drejtoreve. Vlen të theksohet kontrata në shumën prej 20 milion euro ishte barrë për FP e jo për AKP-në, kur dihet se fondet është dashtë të sigurohen nga Buxheti i Kosovës. Formimi i komisionit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik për likuidimin e NSH, ishte në kundërshtim me LPP, ngase në këtë tender morën pjesë menaxherët e AKP-së, si vëzhgues si dhe drejtori i prokurimit ishte edhe kryetar i komisionit vlerësues së tenderit. Problem në vete paraqet edhe shpërndarja e 20%, të mjeteve për ndërmarrjet tashme të privatizuara, si dhe mos azhurnimi i mirë i listave të përfituesve. Kush fillimisht i përgatite listat për 20% e punëtorëve?

Ramiz Lladrovci – Kërkoj sqarim lidhur me të gjeturën e ZAP-it në auditimin e FP dhe AKP, shpallja e tenderit për shërbime të konsulencës në shumën prej 20 milion euro, për likuidimin e ndërmarrjes shoqërore Trepça. Pjesëmarrja e menaxhmentit bashkë me drejtorin e prokurimit ne hapjen dhe vlerësimin e tenderit për këto shërbime, është shkelje e LPP. Po ashtu mungesa e rregullores për të ardhurat e personelit dhe anëtarëve të bordit të AKP-së. Nuk kemi të dhëna sa i parket tatimit të mbajtur në burim për bordin e drejtoreve të AKP-së. Këto rregullore nuk janë në harmoni me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Pyeti; a kanë anëtarët e bordit të AKP-së numra fiskal të lëshuar nga ATK-ja dhe sa është borxhi në raport me shtetin lidhur me këtë?

Afrim Hoti- Kërkoj sqarim lidhur me të gjeturat: emri i përfituesit i ndryshëm në librezën e punës nga libri amëz i punëtorëve. Nga librezja e punës së përfituesit të 20% tek një minoritet serb, emri i përfituesit është i ndryshëm nga libri amëz i punëtorëve. I njëjti në librezën e punës është me një emër ndërsa në librin amëz të punëtorëve është i regjistruar me tjetër emër. Për ndryshimin e emrit për të njëjtin, nuk ka asnjë dokumentim në dosjen e tij. Po ashtu AKP ka shpenzuar materiale administrative për tetë (8) muaj sasinë që e kishte planifikuar për dymbëdhjetë (12) muaj. AKP kishte nënshkruar kontratë të re për furnizim me material administrativ me OE “N.T.P KGT” 4 muaj para skadimit të kontratës paraprake. Po ashtu procedura të kuotimit me vetëm një tenderues të përgjegjshëm- AKP ka zhvilluar procedura të prokurimit me kuotim të çmimit për furnizim me pajisje të IT-së Back Up në vlerë prej 5,155€, duke pasur vetëm një ofertues të përgjegjshëm dhe e ka shpërblyer me kontratë. Kërkoj një sqarim për këtë.

Mursel Haljilji- Pyeti lidhur me menaxhimin e fondeve të privatizimit, mungesa e informimit të AKP-s lidhur me kontraktimin e investimeve nga BQK si ndërmjetësues, mënyra e shkëmbimit të informatave nga BQK lidhur me kontraktimin e depozitave konsiderohet si e papërshtatshme për faktin se AKP nuk ka informacione të qarta se cila normë është norma e

totalit të interesit të fituar nga depozitat e mjeteve të AKP-së. Procesi i kontraktimit gjithashtu ka mangësi pasi që AKP ka pranuar disa opsione të interesave fikse nga BQK, por në të njëjtën kohë nuk ka qenë në dijeni se sa ka qenë pjesa e interesit të BQK-së si ndërmjetësues. Pse nuk ka pasur bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti këto informacione? Po ashtu, një çështje tjetër që ka të bëjë me njoftimin e kuvendeve komunale përkatëse për shitjet përmes procedurave të likuidimit veçanërisht për ndërmarrjen Sharr si dhe shpërndarjen e 20% për ish të punësuarit? Pastaj dua të di çka është bere deri tani me çështjen e trajtimit të objekteve banesore që ishin prone e NSH, kur dihet se kjo çështje ka afatin kohor të zgjedhjes deri në fillim të vitit 2014.

Valbona Dibra- Opinioni i dhënë për AKP dhe FP nuk është i mirë për faktin se është opinion i kualifikuar, që dallon nga vitet paraprake. Bazë për dhënien e këtij opinioni është pagesa e shumës prej 1.2 milion euro nga paratë e Fondit të Privatizimit. Kërkoj sqarim lidhur me mos pagesën e tatimit të mbajtur në burim nga bordi i drejtoreve, për të cilën ka dhënë vërejtje edhe ZAP-i ?

Albert Kinolli- Pyeti lidhur me pagesën e 20% dhe kalkulimet për sa i përket përvojës së punës për të punësuarit në ndërmarrjet tashme të privatizuara. AKP nuk ka rregullore të veçantë për përzgjedhjen dhe kategorizimin e përfitueseve të 20%. Pse deri tani nuk ka bërë një rregullore lidhur me këtë çështje? Si dhe pse AKP ka bërë ristrukturimin e vendeve të punës pa aprovimin nga ana e MAP-it, ku kjo në vete përmban rrezikun e rritjes së faturës së pagave pa ndonjë aprovim paraprak? Në raport të ZAP-it thuhet se AKP nuk ka bërë funksionalizimin e Komitetit të Auditimit, cilat janë shkaqet dhe pengesat në këtë drejtim.

Bali Muharremaj- Pyeti; kur do të bëhet pagesa e 20% të ish punëtorëve të Ballkanit të Suharekës, kur dihet se ka kohë që kjo ndërmarrje është privatizuar dhe ende nuk janë paguar pagat për 5 muaj?

Skender Komoni – AKP gjatë vitit 2012 ka vazhduara me aktivitetet e përcaktuara me ligj. Për mese gjashtë muaj AKP ka funksionuar pa bord të drejtorëve, kjo për arsye se ka skaduar mandati i anëtarëve dhe Kuvendi nuk ka emëruar bordin e ri. AKP ka ofruar të gjitha dëshmitë për të gjeturat e evidentuara nga ZAP. Në përgjithësi të gjeturat janë adresuar dhe presim që të forcojmë funksionimin e kontrollit të brendshëm. ZAP ka dhënë opinion të kualifikuar. Por, marrë në përgjithësi ZAP ka konstatuar se pasqyrat financiare vjetore janë përgatitur në bazë të kornizës raportuese dhe standardeve të parasë se gatshme. Mirëpo, kërkojen veprime shtesë për të adresuar rekomandime të rëndësishme të vitit paraprak. Bordi zotohet se të gjitha rekomandimet do t'i adresoi në tërësi.

Shkëlzen Lluka- Vitin e kaluar kemi pasur dy raporte me opinion të pakualifikuar, ndërsa këtë vit kemi opinionin e kualifikuar, me arsyetimin e me përjashtim të pagesës së paaprovuar për shpenzimet profesionale të likuidimit të NSH-ve të privatizuara. Përbërja e bordit është e kufizuar në mungese të anëtarëve. Emërimi i anëtarëve të bordit nuk është kompetencë e AKP. Këtë çështje e kemi ngritur disa herë me kryetarin e Kuvendit dhe me Kryeministrin. Përbërja e bordit pengon AKP-në në shpërndarjen e mjeteve të cilat ruhen në mirëbesim kreditorët dhe pronarët e mundshëm. AKP ka kryer të gjitha punët rreth shpërndarjes së 20% të punëtorëve kur të gjitha listat e punëtorëve të aprovuar apo për të cilat kemi bërë shpërndarjen deri me sot nga strategjia që të shpërndahet 75%, ne e kemi rritur vlerën në 90%. Çështja tjetër është procesi i likuidimit, ne me automatizëm mund të shpërndanim - alokonim buxhetit të Kosovës përafërsisht 4 milion euro dhe një shumë të konsiderueshme për kreditorët e ndërmarrjeve të cilat janë në likuidim. AKP është dakorduar me Ministrinë e Financave lidhur me parashikimet buxhetore për vitin e ardhshëm. AKP ka nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me ATK lidhur me barra tatimore të cilat i kanë NSH –të ATK-së dhe si rezultat i kësaj ne presim që vitin e ardhshëm AKP të jetë në gjendje të shpërndaj në ATK dhe në Buxhetin e Kosovës shumën prej 30 milion euro.

Kemi kërkuar nga Oda e Veçantë që të gjejmë një zgjidhje lidhur me interpretimin e prezencën e anëtarëve ndërkombëtar në bord, kërkesa jonë është refuzuar. Ne kemi kërkuar edhe amandamentimin e ligjit dhe shpresoj që Komisioni parlamentar ta shqyrtoj kërkesën për amandamentim të ligjit. AKP është peng i mos shpërndarjes së mbi 100 milion euro si pasojë e mungesë së Bordit.

Kontrata për ofruesin e shërbimeve profesionale – kontrata është kryer në bazë të tenderit të hapur ndërkombëtar. Kjo ka qenë domosdoshmëri dhe mu për këtë është ndryshuar ligji. Pas angazhimit ne kemi bërë shpërndarjen buxhetit të Kosovës në vlerën prej 30 milion euro. Kërkesat gjatë periudhës së AKP-së në procesin e likuidimit, ankesat, shqyrtimi i tyre dhe vendosja e tyre ka qenë minimale. Sot numri i ankesave dhe vendimeve të palët arrin shifrën prej 35 mijë vendime që u janë lëshuar palëve. Gjatë vitit 2014 mendojmë që të gjitha NSH-të të hyjnë në procesin e likuidimit.

Lidhur me të gjeturën që ka kualifikuar këtë raport, ne i kemi dërguar letër ZAP-it për mos pajtueshmërinë tonë. AKP pritet të jap mjete në Buxhetin e Kosovës ne të marrim mjete për procesin e likuidimit.

Fillimisht listat përgatiten nga ndërmarrja e cila është privatizuar dhe me pastaj këto lista dorëzohen në AKP për verifikim. Listat përfundojnë për ekzekutim në Oden e veçantë për të dhënë versionin final para se të ekzekutohet pagesa.

Avni Jashari – Lidhur me të gjeturën mos prezantimit të pagesave për realizimin e shpenzimeve profesionale të likuidimit në vlerë 1,228,009€ lidhur me marrëveshjen kontraktuale me një kompani të jashtme- në AKP është diskutuar shumë. Si është e mundur që një agjension i cili ka pasur 8 opinione të pakualifikuar të ketë një opinion të kualifikuar! Për shkak të një shpalosje të cilën e kemi bërë. Në Fq10 të raportit thuhet se AKP nuk e ka prezantuar pagesën për shpenzimet profesionale të likuidimit të NSH-ve të privatizuara në vlerë 1,228,009€. Kjo nuk është e saktë, për shkak se AKP ka shpalosur në 4 raporte financiare të fondeve në mirëbesim. Në të njëjtin raport të auditorit fq 4 thuhet *“Sipas opinionit tonë Pasqyrat e Rrjedhës së Parasë prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të pagesës së paaprovuar për shpenzimet profesionale të likuidimit të NSH-ve të privatizuara në vlerë 1,228,009€ e cila është bërë pa bazë ligjore”*. Pagesa për shpenzimet profesionale janë aprovuar që nga zyrtarët kontrollues në zyrat rajonale, nga Drejtori i departamentit të likuidimit, nga zëvendës drejtori i Departamentit të likuidimit, Drejtori menaxhues, Drejtori i financave dhe Zyrtari certifikues. Lidhur me kontratën 20 milion euro, në i kemi shpjeguar auditorit se janë dy provizione në Ligjin e AKP-së që kanë dy kuptime. Një provizion në Ligjin e AKP-së thotë se kjo kontratë do të financohet nga Buxheti i Kosovës. Ndërsa, tjetri thotë se do të paguhet nga fondet e likuidimit, do të paguhet shpenzimet e autoritetit të likuidimit të nevojshme për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe aseteve të ndërmarrjes. Sipas këtij ligji thotë do të paguhet shpenzimet e autoritetit të likuidimit dhe të këshilltarëve mbështetës. Duke u bazuar në këtë, njësia e kërkesës ka përgatitur deklaratën e nevojave e cila është proceduar në Departamentin e financave dhe duke u bazuar në nenin 40 të Ligjit të AKP-së është konfirmuar nga Departamenti i financave se ekzistojnë fonde të mjaftueshme në Fondin e Mirëbesimit. Një pagesë e tillë është praktikë në çdo shtet që është marrë me likuidimin e kompanive. Vetëm në rastet kur ndonjë ndërmarrje shoqërore nuk do të kishte fonde të mjaftueshme në likuidim, atëherë ato mjete do të merreshin prej Buxhetit të Kosovës apo prej tarifës administrative. Nëse NSH kanë mjete të mjaftueshme në fondet e tyre të likuidimit atëherë pse duhet të merren pjetet për këtë proces nga BK e jo nga fondi i këtyre ndërmarrjeve. AKP ka vepruar në përputhje të plotë me ligjin. Ne kemi biseduar me MF dhe me kërkesën buxhetore 2013 dhe në vitin 2014 të gjitha kostot e likuidimit tani do të financohen nga fondet në likuidim.

Ramiz Lladrovci - Tha se AKP ka dërguar letra në ZAP, pasi që ka dal opinionin. Komentet është dashur të jepen brenda afatit ligjor, jo pasi që Auditori jep mendimin përfundimtar të tij.

Pastaj ka të gjetura të tjera shumë më serioze se kjo. Në vlerësimin e tenderit kanë marrë pjesë Drejtorët e Bordit. Kjo është shkelje e rëndë e LPP. Pastaj, në një mbledhje të komisionit vlerësues ka marrë pjesë zyrtarja e prokurimit që është në kundërshtim me ligjin. Kjo shkelje ka të bëjë pikërisht me kontratën për të cilën është kualifikuar raporti për këtë institucion. Asnjë pagese që tejkalon shumë e mjeteve të ndara për AKP nuk guxon të bëhet pa marrë aprovim nga Kuvendi i Kosovës. Kërkoj sqarime lidhur me këto. Pastaj më intereson të dijë a ka evidencë AKP për numrin e pronave shoqërore, që janë nën administrim të AKP-së. Tentimi për shitblerje të tyre po paraqet probleme në mes qytetareve?

Avni Jashari - Lidhur me të gjeturën për mos pagesën tatimi në burim ne e kemi refuzuar këtë të gjetur, me arsyetimin se kemi një interpretim nga ATK sipas të cilit AKP duhet të mbaj tatimin në burim dhe të paguaj në shkallën 10%. Për anëtarët e bordit vendor dhe ndërkombëtar, përveç se për stafin ndërkombëtar nuk paguani kontributet pensionale. Lidhur me këtë ne kemi njoftuar ZAP. Për anëtarët e bordit jo rezident i nënshtrohen tatimit në burim të të ardhurave, 5% e kompensimit bruto. Përderisa anëtarët rezident nuk janë të punësuar në AKP dhe ne nuk mund të ndalim tatimin e mbajtur në burim, sipas kësaj kjo nuk bie në përgjegjësi të AKP-së, por është përgjegjësi individuale e anëtarëve të bordit. Ata duhet të dorëzojnë një deklaratë dhe ta paguajnë tatimin në fund të vitit. Anëtarët rezident i nënshtrohen tatimit në burim të të ardhurave 10%.

Haxhi Arifi - Për sa i përket çështjes të privatizimit fillimisht është marrë faktori ndërkombëtar, dhe ne si bord nuk jemi të kënaqur me punën që është bërë me numrin e lëndëve të shqyrtuara atëherë. Sa i përket AKP-së dhe punës së bërë për shpërndarjen e 20%, tani çështja ka ngecur në Odën e Veçantë. Ne si bord jemi të pakënaqur me punën e kësaj gjykate, ku nga 300 ankesa janë shqyrtuar vetëm 5 prej tyre. AKP ka dorëzuar të gjitha listat, mirëpo ngecje ka në Odën e veçantë. E njëjta situatë është edhe me punëtoret e Ballkanit të Suharekës. Po ashtu pagesa bëhet me standarde të dyfishta, për shqiptar tjera standarde, ndërsa për të tjerët jo shqiptar standarde të tjera, veçanërisht në kalkulimin e përvojës së punës.

Artan Venhari- Pagesa është e parregullt, sepse shuma e paguar ishte e paaprovuar dhe pa bazë ligjore. AKP i është referuar Ligjit për AKP sipas të cilit neni 16 thotë “ *tarifat dhe shpenzimet e ofertuesit të shërbimeve profesionale paguhen nga mjetet që i janë ndarë agjencisë nga Buxheti i Republikës së Kosovës ose nga mjetet e siguruara nga ndonjë donator*”. Nëse është dashur të merren mjetet nga Fondi në Mirëbesim, lidhur me këtë është dashur të merret edhe mendimi i Kuvendit. Raporti është kualifikuar vetëm në këtë çështje. Sipas raportit të ZAP-it është thënë se duhet një kontroll më i mire në shpërndarjen e 20% nga vet AKP. Raportet e auditorit flasin për sistemin e jo për individët, ndërsa në komunikimin me AKP çështjet janë me emra në rastin konkret të përfituesit të 20%.

Myrvete Gashi, ZAP - Zyrtarja e prokurimit ka qenë kryesuese e Komisionit për këtë kemi dëshmi. Pastaj lidhur me këtë nuk ka kundërshti nga AKP. Sa i përket pasqyrimit në pasqyrat financiare është e vërtetë që kjo është pasqyruar në rrjedhën e keshit të fondit. Pagesa nuk është e rregullt, sepse shuma është paguar e pa aprovuar dhe pa bazë ligjore. Në pasqyrat vjetore të AKP-së këto mjetet nuk janë prezantuar fare.

Shkelzen Lluca - Është e vërtetë se Ligji për AKP-ne, na obligon të i trajtojmë vetëm objektet banesore që janë pronë e NP, por jo edhe ato që pronar janë personat juridik.

Të gjitha pronat të cilat gjenden në territorin e Republikës së Kosovës e që janë Ndërmarrje Shoqërore janë nën administrim të AKP-së. Është e vërtetë se ka tendenca për malversime me këto prona, ne i kemi sugjeruar edhe komunave që të mos bëjnë regjistrimin e këtyre pronave në regjistrat kadastral pa një konfirmim nga ana e AKP-së.

Albert Kinolli – Te shpërndarja e 20%, u përmend se komuniteti shumicë kanë qenë të

diskriminuar dhe se është punuar me dy standarde. Ka pas raste ku komunitetet pakicë kanë përfituar vetëm më një shkresë apo ankesë. A keni menduar në një komunitet të caktuar apo në të gjitha komunitetet. Në të gjitha rastet kur flitet për komunitetin serb ju referoheni të gjitha komuniteteve. Ju dëshmoj se ka raste kur anëtari i komunitetit rom nuk ka realizuar të drejtën në 20% (nuk ka ditur shkrim lexim për ankesë), ndërsa në anën tjetër ka njerëz të cilët me dy ditë përvojë pune janë përfitues të kësaj. Çka kanë ndërmarr rreth shpërndarjes dhe dokumentimit të plotë të përfituesve të 20%?

Haxhi Arifi - Problem kemi pasur vetëm me komunitetin serb. Kjo është një proces i gjatë. Por, duhet të dimë gjenezën se pse? Arsytet se pse ka ndodhur kështu duhet kërkuar në Dhomën e veçantë.

Shkelzen Llluka - Në përbërjen e Komisioneve nuk është e ndaluar pjesëmarrja e anëtarit të lartë. Pjesëmarrja e zyrtarës së prokurimit në komision vlerësues nuk ka qenë në rolin e kryesueses, por në rolin e këshilltares.

Ekzistojnë 5 panele për lëndet që shkojnë nga AKP në Dhomën e veçantë, ndërsa vetëm një prej tyre merret me shqyrtimin e lendeve të 20% të punëtorëve. Me ligjin e ri kemi kërkuar që të shtohet numri i paneleve. Raportet e dorëzuara nga AKP në Oden e veçantë nuk po mundën të kryhen për shkak të numrit të vogël të gjykatësve të angazhuar në këtë gjykatë.

Të gjithë kanë të drejtën e ankesës. Ata të cilët nuk kanë bërë ankesë apo NSH nuk i ka përfshirë në listë, kjo nuk bie në kompetencë të AKP-së.

Kryetari – Propozoi që raporti t'i procedohet mbledhjes plenare për shqyrtim bashkë me rekomandimet e Komisionit. Pjesë e rekomandimeve propozoi të jetë edhe auditimi i procesit të shpërndarjes së 20%.

Valbona Dibra - Ishte e mendimit që raportet e auditimit të AKP-së dhe të Fondit të Privatizimit, nuk duhet të procedohet në mbledhje plenare. Po ashtu ishte kundër auditimit të procesit të shpërndarjes së 20%. Propozoi që AKP-së t'i bëhet auditim i performancës e jo kapacitetet e ZAP-it të ngarkohen me auditim të tillë. Personalisht përkrah të gjitha rekomandimet e tjera, përpos rekomandimit për auditim të procesit të 20%.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për rekomandimin nr 1, 2, 3, 4, njëzëri, ndërsa për rekomandimin nr 5 me një votë kundër, ka vendosur që Kuvendi t'i

REKOMANDOJ

1. **Qeveria e Republikës së Kosovës, të përfshijë në Strategjinë Legjislative për vitin 2014, plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Agjensionin Kosovar të Privatizimit, me fokus në qartësimin e procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.**
2. **Agjensioni Kosovar i Privatizimit të bëjë harmonizimin e rregullave të brendshme për kompensim të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve me Ligjin Nr03/L161 mbi të ardhurat personale.**
3. **Agjensioni Kosovar i Privatizimit të hartoj rregullore të brendshme për kompensim të stafit, në përputhje me Ligjin për paga të shërbyesve civil.**
4. **Agjensioni Kosovar i Privatizimit me raport me shkrim, të njoftoj Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me të ardhurat personale të paguara të Bordit të Drejtorëve, tatimin e ndaluar në burim sipas ligjeve në fuqi.**

5. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të bëjë auditim të performancës për procesin e ndarjes së 20%.

4. Të ndryshme

a) Mbledhja e radhës

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se mbledhja e radhës do të mbahet me datën 17 dhjetor 2013, ora 10:00. Në rend dite do të jenë shqyrtimi i rekomandimeve për raportet e auditimit në sektorin e shëndetësisë. Ndërsa, shqyrtimi i Raportit të performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012, sipas mendimit të tij nuk duhet të bëhet nga KMFP, meqenëse në këtë vit Komisioni nuk ka materie për shqyrtim, duke u bazuar në atë se ZAP nuk ka kryer auditim të këtyre ndërmarrjeve.

Ramiz Lladrovci- Ishte i mendimit që Raporti për performancën e Ndërmarrjeve Publike duhet të shqyrtohet në Komision. Këto ndërmarrje i ka audituar auditori i pavarur dhe mbi bazën e tyre është hartuar ky raport.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që për kryesinë e Kuvendit të procedoj këtë

Njoftim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ka vlerësuar se meqenëse Ndërmarrjet Publike në vitin 2012, nuk janë audituar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, të cilat raporte Komisioni i merr për bazë gjatë mbikëqyrjes së shpenzimit të parasë publike, atëherë Komisioni nuk ka nevojë ta shqyrtoj këtë raport, meqenëse të njëjtin e ka shqyrtuar edhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Komisioni është i mendimit që Raporti për Performancën e Ndërmarrjeve Publike për vitin 2012, të renditet për shqyrtim në mbledhje plenare, pa mendimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu